



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/39

Datë: 08.10.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 tetor 2008, mori

V E N D I M

1. Themelohet grupi punues ndërqeveritar për privatizimin e distribucionit dhe furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1) Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave- kryesues
 - 2) Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – anëtar
 - 3) Ministrja e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave – anëtar
 - 4) Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – anëtar
 - 5) Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – anëtar
2. Grupi punues sipas pikës 1. të këtij vendimi do t'i rekomandoj Qeverisë se cilat divizione në kuadër të Korporatës Energjetike të Kosovës do të privatizohen.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë